



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

Nr. 149 Prot.

Tiranë, më 05.03.2021

URDHËR

Nr. 18, datë 05.03.2021

PËR

**“DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR METODOLOGJINË
E TESTIMIT TË INSPEKTORËVE SHTETËRORË DHE VENDORË, MIRATUAR
ME URDHËR NR. 21, DATË 10.06.2020”**


Në mbështetje të pikës 2, të nenit 16 dhe pikës 1 dhe 2, të nenit 21, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektim”, Udhëzimit nr. 1, datë 25.02.2020, “Për procedurën e trajnimit, testimit fillestar dhe periodik, si dhe kriteret përkatëse të vlerësimit të inspektorëve shtetërorë dhe vendorë”;

URDHËROJ:

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për metodologjinë e testimit të inspektorëve shtetërorë dhe vendorë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Ngarkohen inspektorët shtetërorë, vendorë si dhe të strukturave përgjegjëse sipas fushave të inspektimit, ku marrëdhëniet e punësimit të të cilëve rregullohen me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, për zbatimin e këtij Urdhri.
3. Ky Urdhër publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al, si dhe iu njoftohet Inspektorateve Shtetërore, Vendore dhe strukturave përgjegjëse sipas fushave të inspektimit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
SHKËLQIM HAJDARI**



Në rregulloren për metodologjinë e testimit të inspektorëve shtetërorë dhe vendorë, miratuar me urdhër nr. 21, datë 10.06.2020, bëhen këto shtesa dhe ndryshime, si më poshtë:

1. Në Kreun II:

a) Pika 4, riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 4

Inspektori i Përgjithshëm dhe Inspektorati Qendror

1. Inspektori i Përgjithshëm:

- a. Miraton anëtarët e KVFP dhe KSHA;
- b. Siguron, në bashkëpunim me KVFP, plotësimin dhe përputhshmërinë e kushteve të mjediseve ku zhvillohet testimi;
- c. Miraton listën e inspektorëve që do të trajnohen dhe testohen.
- d. Miraton programin e trajnimit, testimit fillestar dhe periodik
- e. Cakton dhe njofton datën e trajnimit, testimit fillestar dhe periodik.
- f. Dërgon zyrtarisht në inspektorat listën e inspektorëve të testuar dhe rezultatet përkatëse.
- g. Pajis me certifikatë inspektorët që kanë kaluar testimin.
- h. Për shkeljet e kësaj Rregullore, propozon masa disiplinore dhe ia përcjell për zbatim institucionit përkatës

2. Inspektorati Qendror:

- a. Administrimin, nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, bazën e të dhënave të inspektorëve pjesëmarrës në testim;
 - b. Krijon akses, përmes sistemit “*e-Inspektimi*”, për regjistrimin e bazës së të dhënave për rezultatet e testimit të vëna në dispozicion nga KVFP;
 - c. Gjeneron dhe printon, përmes sistemit “*e-inspektimi*”, certifikatën e testimit;
 - d. Përpunon modulën e të dhënave, për kopjet e testeve dhe rezultatet për çdo inspektor, në sistemin “*e-inspektimi*”;
 - e. Arkivon të gjitha materialet e procesit të testimit;
 - f. Ruan në format elektronik dhe administron të gjitha të dhënat e procesit të testimit;
 - g. Publikon materiale informuese dhe ndihmëse për provimin e testimit.
 - h. Koordinon veprimtarinë ndërmjet Inspektorati Qendror, inspektoratit dhe njërive të burimeve njerëzore në inspektorat.
 - i. Organizon hedhjen e të dhënave në sistemin “*e-Inspektimi*” për testet e vlerësuar.”.
- b) Në pikën 5, gerrat a, c, e dhe l hiqen, në germen m, fjalët “Inspektorati Qendror” zëvendësohen me “Inspektori i Përgjithshëm” dhe në germen n, fjalët “dhe siguron” hiqen.
- c) Në nenin 6, në fjalinë hyrëse, pas fjalës “KVFP” shtohen fjalët “dhe anëtarin e KSHA” dhe fjalët “për inspektoratin” hiqen.

- d) Në nenin 7, në pikën e, fjalët “Inspektorati Qendror” zëvendësohen me “Inspektori i Përgjithshëm” dhe në fund të germës f, fjalët “dhe shqyrton ankesat në këtë rast” hiqen.

2. Në Kreun III:

- a) Në nenin 9, pika 1 riformulohet me këtë përmbajtje: “Testimi fillestar kryhet me shkrim dhe me gojë, ndërsa testimi periodik vetëm me shkrim” dhe pika 2 hiqet.
- b) Në nenin 11, pika 3 riformulohet me këtë përmbajtje: “Lista e inspektorëve që do të marrin pjesë në testimin fillestar dhe periodik, shpallet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror. Kjo listë i dërgohet zyrtarisht inspektoratit përkatës nga Inspektori i Përgjithshëm.”.
- c) Në nenin 16, pika 1 hiqet,

3. Në Kreun VI:

- a) Në nenin 20, në pikën 5, fjalët “Inspektorati Qendror” zëvendësohen me “Inspektori i Përgjithshëm”, në pikën 6, pas fjalës “testit” shtohen fjalët “me shkrim dhe me gojë” dhe pikat 1, 2 dhe 10 riformulohen me këtë përmbajtje:
- “1. KVFP shpall skemën e vlerësimit të testit, para fillimit të testimit (pikët për secilën pyetje, si dhe raportin bazë/sectorial), e cila miratohet nga Inspektori i Përgjithshëm.
2. Vlerësimi i përgjigjeve të inspektorit bëhet me pikë, si për testimin me shkrim dhe në atë gojë. Vlerësimi i testimit fillestarë është 75 pikë me shkrim dhe 25 me gojë, ndërsa për testimin periodik 100 pike me shkrim.
10. Brenda 15 ditëve nga përfundimi i testimit, Inspektorati Qendror harton listat e inspektorëve, së bashku me vlerësimet përkatëse dhe i publikon në faqen zyrtare, pas miratimit nga Inspektori i Përgjithshëm. Kjo listë i njoftohet inspektorateve nga IP edhe me shkresë zyrtare.”.
- b) Në nenin 21, germa a, e pikës 2 riformulohet me këtë përmbajtje: “Çdo pyetje ka, 3 deri ne 5 alternativa” dhe pikat 1 dhe 3 riformulohen me këtë përmbajtje:
- “1. Në testimin me shkrim përgjigja e saktë vlerësohet 3 pikë, për testimin fillestar dhe 4 pikë për testimin periodik. Përgjigja e gabuar vlerësohet 0 pikë.
3. Testi përmban afërsisht, 50 % për pyetje nga ligji për inspektimin dhe aktet ligjore e nënligjore të tjera dhe 50 % nga legjislacioni sectorial.”.

- c) Pas nenit 20 shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/1

Përmbajtja e testit me gojë

1. KVFP para fillimit të testimit me gojë harton bankën e pyetjeve dhe pikët përkatëse për çdo përgjigje, të cilën e miraton Inspektori i Përgjithshëm.
2. KVFP duhet të garantojë parimin e barazisë për çdo inspektor.”
- d) Në nenin 22, te titulli hiqet fjala “digjital” dhe në pikën 1, pas fjalës “Qendror” shtohen fjalët “, ose manualisht në rast të mungesës së saj.”.

4. Në Kreun VII:

Në nenin 23, në pikën 2, fjalët “Komisionit *ad-hoc* të shqyrtimit të ankesave” zëvendësohen me “Inspektorit të Përgjithshëm”, në pikën 3, fjalët “kthen përgjigje” zëvendësohen me “merr vendim” dhe pikat 4 e 5 riformulohen me këtë përmbajtje:

“4. Vendimi i Komisionit të shqyrtimit të ankesave i njoftohet Inspektorit të Përgjithshëm.

5. Vendimi i Komisionit të shqyrtimit të ankesave është përfundimtar dhe mund të ankimoret vetëm në gjykatë.”.

5. Në Kreun IX:

Në nenin 25, në pikën 2, fjalët “Inspektorati Qendror” zëvendësohen me “Inspektori i Përgjithshëm”.

Kudo në rregullore fjala “KVT” zëvendësohet me “KVFP”.